



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr. 8/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e [REDACTED] të parashtruar ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të refuzimit të aplikimit për të votuar si votues jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me date 07 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 26.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pa bazuar ankesa ZP Anr 8/2026 e datës 24.05.2026, e parashtruar nga [REDACTED] parashtruar ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të refuzimit të aplikimit për të votuar si votues jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me date 07 Qershor 2026.

A r s y e t i m

Më datë 24.05.2026, PZAP-i, përmes e-mailit zyrtar ka pranuar një ankesë ZP.Anr.8/2026 nga [REDACTED] paraqitur ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për shkak të refuzimit të regjistrimit si votues jashtë Kosovës. Parashtruesja e ankesës thekson se pas pranimit të njoftimit për refuzim nga KQZ, është udhëzuar që brenda afatit prej 24 orësh të dërgoj fotografi shtesë për verifikim të identitetit. E njëjta në ankesë thekson se i ka dërguar brenda afatit të kërkuar fotografitë dhe videon si dëshmi që ka aplikuar sipas udhëzimeve të KQZ-së. Sipas parashtrueses së ankesës fotografia është realizuar në kohë reale dhe dokumenti identifikues i Republikës së Kosovës është paraqitur në dorë ashtu siç është kërkuar. E njëjta thekson se megjithatë aplikimi i saj vazhdon të mbetet i refuzuar dhe nuk ka pranuar shqyrtim të drejtë të dëshmimeve të dëguara, dhe duke kërkuar nga PZAP që të shqyrtojë rastin e saj dhe të mundësojë rishqyrtimin e aplikimit për regjistrim në votim jashtë Kosovës. Si dëshmi ka bashkangjitur fotografinë për verifikim, dokumentin identifikues, screenshot-in e refuzimit nga KQZ, dëshmitë e dërgimit të kundërshtimit, videon si dëshmi.

Në përgjigje në kërkesë KQZ-ja, ka theksuar se lidhur me ankesën Anr, 08/2026, që ka të bëjë me regjistrimin për votim jashtë Kosovës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen më 7 qershor 2026, ju njoftojmë si në vijim: shtetasja znj. [REDACTED] (më tej ankuesi), me numër personal të identifikimit të

Republikës së Kosovës [REDAKTUAR] ka aplikuar përmes platformës elektronike. Divizioni i shërbimit të votuesve ka shqyrtuar dhe ka refuzuar aplikimin e ankuesit dhe i njëjti është njoftuar përmes emailit, në email adresën e dhënë gjatë aplikimit [REDAKTUAR]. Arsyet pse është refuzuar kërkesa e aplikuesit janë: Ka munguar fotografia e aplikueses me dokument identifikues të Kosovës në dorë, nuk është bërë fotografia e aplikuesit për qëllim të verifikimit të identitetit, fotografitë nuk janë bërë në kohë reale. Si provë ka bashkangjitur fotografitë e aplikuesës. Në përgjigje më tej theksohet se për qëllim të ruajtjes së integritetit dhe sigurisë së procesit zgjedhor platforma elektronike e regjistrimit e KQZ-së nuk lejon ngarkimin e fotografive të gatshme nga pajisje të tjera. Gjatë procesit të aplikimit, sistemi aktivizon kamerën dhe kërkon që fotografitë të realizohen në kohë reale, fillimisht fotografia e votuesit për verifikim të identitetit dhe më pas dokumentet mbështetëse, përfshirë fotografinë e aplikuesit me dokumentin identifikues të Kosovës në dorë. Nga shqyrtimi i aplikimit është konstatuar se fotografitë e paraqitura nuk janë realizuar në kohë reale, por janë fotografuar nga një pajisje tjetër. Kjo krijon dyshime të arsyeshme se ankuesja, znj. [REDAKTUAR] nuk ka qenë personalisht prezentë gjatë procesit të aplikimit duke rrezikuar kështu mundësinë e keqpërdorimit të së drejtës së votës. Po ashtu, është konstatuar se aplikimi është dorëzuar nga një email adresë që nuk përmban emrin apo mbiemrin e ankueses, por të një personi tjetër, çka ka shtuar dyshimet lidhur me autenticitetin dhe besueshmërinë e aplikimit. Duke u bazuar në nenin 3, pika 4 të Rregullores Zgjedhore 04/2025 Regjistrimi dhe Votimi jashtë Kosovës, si dhe plotësim ndryshimin 01/2026, KQZ ka refuzuar kërkesën e aplikuesit për arsyet e lartcekura.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësja, pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore konstatoi se:

- *Ankesa është e pa bazuar.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtrësja e ankesës [REDAKTUAR] ka aplikuar për regjistrim si votuese jashtë Kosovës përmes platformës elektronike të KQZ-së. Pas shqyrtimit të aplikimit, Divizioni i Shërbimit të Votuesve në KQZ e ka refuzuar aplikimin, me arsyetimin se ka munguar fotografia e aplikueses me dokument identifikues të Republikës së Kosovës në dorë, fotografia për verifikim të identitetit nuk është realizuar sipas kërkesave të sistemit dhe fotografitë nuk janë realizuar në kohë reale. Parashtrësja në ankesën e saj ka pretenduar se fotografitë dhe video-incizimin i ka dërguar brenda afatit të kërkuar nga KQZ-ja dhe se ka vepruar sipas udhëzimeve të pranuar për verifikim të identitetit.

Me nenin 3 paragrafin 4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025, Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës të KQZ-së, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren 01/2026, është përcaktuar se “4. Kërkesa për regjistrim përmes platformës elektronike të KQZ bëhet si në vijim: 4.1. Plotëson të dhënat e adresës së banimit jashtë Kosovës: shtetin, kodin postar, qytetin, emrin e rrugës, numrin e banesës apo shtëpisë; 4.2. Plotëson email adresën personale dhe numrin e telefonit mobil personal; 4.3. fotografon njërin prej dokumenteve identifikuese të lëshuara nga Republika e Kosovës, si letërnjoftim, pasaportë ose patentë shofer, duke mos përfshirë dokumentet me afat të skaduar; 4.4. fotografon dokumentin që dëshmon adresën e votuesit jashtë Kosovës, sikurse në nën paragrafin 4.1...”; 4.5 bën verifikimin e dyfishtë të identitetit të votuesit përmes fotografimit në kohë reale gjatë aplikimit ku shihet fytyra e tij/saj dhe mbanë

në dorë dokument identifikues të Republikës së Kosovës, apo përmes skanimit biometrik me njohje te fytyrës.

Paneli, pas shqyrtimit të provave të bashkangjitura nga palët, përgjigjes së KQZ-së dhe dokumentacionit përcjellës, vlerëson se ankesa është e pabazuar pasi që nga provat e administruara është konstatuar se sistemi elektronik i KQZ-së kërkon që fotografitë për verifikim të identitetit të realizohen drejtpërdrejt në kohë reale përmes kamerës së pajisjes gjatë procesit të aplikimit. Sipas sqarimeve të KQZ-së dhe provave të bashkangjitura, fotografitë e paraqitura nga ankuesja nuk janë realizuar në kohë reale përmes platformës, por janë fotografuar nga pajisje tjetër, çka bie ndesh me kërkesat procedurale të përcaktuara për regjistrim. Paneli vlerëson se kërkesat teknike dhe procedurale të vendosura nga KQZ-ja kanë për qëllim garantimin e integritetit të procesit zgjedhor dhe parandalimin e keqpërdorimit të së drejtës së votës dhe se mosplotësimi i këtyre kërkesave përbën bazë të mjaftueshme ligjore për refuzimin e aplikimit për regjistrim si votues jashtë Kosovës.

Po ashtu, Paneli mori parasysh edhe faktin se aplikimi është bërë nga një adresë elektronike që nuk përmban të dhëna identifikuese të ankueses, rrethanë kjo e cila ka ngritur dyshime shtesë lidhur me autenticitetin e aplikimit. Andaj, duke u bazuar në nenin 3 paragrafi 4 të Rregullores Zgjedhore Nr.04/2025 për Regjistrimin dhe Votimin jashtë Kosovës, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr.01/2026 si dhe në provat e administruara në këtë çështje, Paneli gjeti se refuzimi nga ana e KQZ-së për ta regjistruar si votuese jashtë Kosovës parashtruesen e ankesës është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesja e ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.

Andaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3, 118 paragrafi 1, neni 119 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe në bazë të nenit 9 paragrafi 5.3 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr. 8/2026 më datën 26.05.2026

Kryesues i Panelit

Arsim Hamzaj



KËSHILLAJURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.